



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06-6747/9 dt. 28.03.2013
Mitrovicë

RREGULLORJA NR. 11/2013
PËR
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Mitrovicë, mars 2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS

Nr. 02/06-6747/9 dt. 28.03.2013

Mitrovicë

Në pajtim me nenin 12 pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen e lokale (Gaz. e R.K Nr. 28 dt. 4 qershor 2008), neni 43 paragrafi 3 Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/08 MEF-it - Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe neni 39 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Mitrovicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 28.03.2013 nxjerrë:

RREGULLOREN NR. 11/2013
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

- 1.1 Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të Komunës së Mitrovicës nga fondi për subvencione dhe transfere, personave fizik dhe juridik.
- 1.2 Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin kalendarik, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndanë mjete financiare buxhetore ndihmë momentale, për personat juridik dhe fizikë sipas procedurës së përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 2

Ndihmë momentale sipas kësaj Rregulloreje konsiderohet ndihma e njëhershme në para të gatshme e cila palës i transferohet përmes llogarisë bankare sipas propozimit nga komisioni apo organet përkatëse komunale me vendim të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Subvencion konsiderohet ndihma momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurëse) dhe mbështetja financiare që u jepet personave fizik.

Neni 4

Subvencionet-ndihmat e njëanshme momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurëse)

Personat juridik të certifikuar për veprimtari jofitimprurëse, institucionet dhe OJQ-të, klubet, shoqatat e ndryshme amatore në fushën e kulturës, arsimit, rinisë, sportit, artit, bujqësisë, aktivitetet që e promovojnë dhe përkrahin zhvillimin ekonomik etj., mund të përfitojnë subvencione sipas kriterëve të publikuara në media nga organet e administratës publike të Komunës apo duke iu drejtuar për ndihmë Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Procesi i publikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për subvencione

- 5.1 Organet Komunale shpallin ftesën për aplikim të ndarjes së subvencioneve nga fushëveprimtaria e tyre.
- 5.2 Të gjitha fletëaplikacionet dorëzohen në Zyrën e pranimit dhe protokollimit që i drejtohen organit përkatës për shqyrtim apo Kryetarit të Komunës, varësisht nga publikimi i shpalljes dhe aplikimi për përfitimin e subvencioneve.
- 5.3 Organi i caktuar në afat ligjor i shqyrton aplikacionet dhe bie propozim-vendim.
- 5.4 Organet e Komunës mund t'i trajtojnë kërkesat e palëve me interes komunal pa shpallje publike.
- 5.5 Dokumentacioni i nevojshëm për përfitim të subvencionit për persona juridik:
 - 5.5.1 certifikata e regjistrimit,
 - 5.5.2 arsyetimi i kërkesës me projekt të qartë dhe bindës,
 - 5.5.3 fotokopja e letërnjoftimit të udhëheqësit të organizatës,
 - 5.5.4 llogaria bankare e personit juridik jofitimprurës, dhe
 - 5.5.5 informatë vjetore mbi aktivitetin qarkullimin financiar.

Neni 6

- 6.1 Komisioni apo organi i caktuar për shqyrtim të kërkesave për ndarjen e subvencioneve shqyrton kërkesat dhe ia dorëzon drejtorit të drejtorisë përkatëse.
- 6.2 Drejtori i drejtorisë mbi bazën e raportit të Komisionit nga pika 1 e këtij neni propozon, respektivisht i rekomandon Kryetarit të Komunës propozimin për vendimmarrje duke ia bashkangjitur dokumentacionin përcjellës.

Neni 7

- 7.1 Kryetari i Komunës, merr vendim lidhur me kërkesën e personit juridik, deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.
- 7.2 Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik deri në shumën prej 2.000.00 €, përveç në rastet ku me këtë rregullore parashihet ndryshe.

- 7.3 Nëse ndihmat financiare kanë të bëjnë me shuma më të mëdha, se që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, për të njëjtën vendosë Komiteti për Politikë dhe Financa (me vendim paraprak mbi delegimin e kësaj kompetence nga Kuvendi i Komunës), kurse Kuvendit i paraqet raport për çdo gjashtë (6) muaj.
- 7.4 Përjashtim nga pika 2 dhe 3 e këtij neni bëhet në rastet kur subvencionohen projektet që parashihen me planet e punës të institucioneve nën autoritetin e Komunës, rastet kur projektet realizohen nga institucionet komunale për shënimin e datave dhe manifestimeve me rëndësi Shtetërore dhe Komunale, si dhe projektet që realizohen me bashkëfinancim.

Neni 8

Kriteret për financimin e projekteve nga subvencionet

- 8.1 Projektet nga fusha e kulturës (promovimet e vlerave përmes festivaleve, koncerteve, shënimin e datave historike dhe kulturore, simpoziumeve, ekspozitave dhe promovimi i librave të botuara etj).
- 8.2 Shuma e mjeteve caktohet sipas projektit duke elaboruar me pjesën buxhetore si në vijim:
- 8.2.1 Veprimtaria botuese (për shpenzimet e shtypit, subvencioni fitohet në bazë të recensionit nga dy krijues të verifikuar në lëmin përkatëse letrare);
 - 8.2.2 Veprimtaria teatrale (vlerësimi bëhet në bazë të kalkulimit të shpenzimeve të shfaqjeve teatrale);
 - 8.2.3 Veprimtaria filmike (vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve të kalkuluar sipas zhanrit dhe skenarit në vlerë prej 30% deri në 40%, pasi pozicionet filmike janë më të shtrenjta se ato teatrale);
 - 8.2.4 Artet pamore (subvencionohet botimi i katalogëve dhe kornizimi i pikturave);
 - 8.2.5 Trashëgimia kulturore (hulumtimi i trashëgimisë, gërmimet arkeologjike, ruajtja, restaurimi dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë mbështetet sipas rëndësisë së objekteve që duhet hulumtuar dhe ruajtur dhe atë në fazë. Vlerësimi për ndarjen e shumave bëhet sipas mendimit të ekspertëve të fushës së caktuar në lartësi deri në 40% pasi gërmimet, restaurimet dhe konservimet janë të kushtueshme.
 - 8.2.6 Grupet artistike të Mitrovicës (puna e tyre vlerësohet duke u mbështetur në realizimin e suksesshëm të programeve të mirëfillta që kanë vlera artistike. Projektet e tyre që duhet mbështetur janë: pjesëmarrja në festivale brenda dhe jashtë vendit, koncertet e ndryshme, pajisjet me gardërobë konvencionale dhe instrumente muzikore, ndihmat logjistike-sigurimi i sallave për mbajtjen e koncerteve, lokalet ku do t'i përgatisin programet, shpenzimet për udhëtime të shkurtra dhe ndonjë ndihmë tjetër ku Komuna nuk ka shpenzime të theksuara).
 - 8.2.7 Projektet e këtij lëmi duhet të kenë vlera krijuese artistike të specifikuar me pjesën buxhetore.

Neni 9

Projektet për çështje gjinore dhe integritet socio – kulturore që promovojnë:

- 9.1 Arritjen e barazisë gjinore nëpërmjet integritet, perspektivës gjinore në të gjitha sferat:
- 9.1.1 përmirësimin e mbrojtjes dhe parandalimit e dhunës në familje;

- 9.1.2 eliminimin e pabarazisë së grave dhe vajzave në veprimtarit shoqërore dhe politike, arsim, shëndetësi etj.;
- 9.1.3 integrimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat;
- 9.1.4 përkrahjen në aftësimin e përkthyesve të shenjave për personat shurdhmemec si kategori e veçantë.

Neni 10

Projektet për fuqizimin e rinisë dhe organizimeve të saja

10.1 Projektet në fushën e sportit:

- 10.1.1 Masivizimi i sportit për të rinj;
- 10.1.2 Përkrahje të qëndrueshme financiare për sportistët kulmor dhe klubet;
- 10.1.3 Avancimin e organizimit në klubet sportive të femrave;
- 10.1.4 Bashkëpunimi me organizata të ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare;
- 10.1.5 Integrimin e minoriteteve në aktivitete të rregullta kosovare;
- 10.1.6 Kultivimi dhe avancimi i kualiteteve menaxhuese, për funksionimin profesional dhe amator të klubeve sportive;
- 10.1.7 Përkrahje të vazhdueshme për Shoqatat e Pedagogëve të Kulturës Fizike me qëllim të zhvillimit të Ligës shkollore në nivel lokal dhe rajonal;
- 10.1.8 Partneritet me të gjitha organizatat sportive për implementimin e politikave zhvillimore afatshkurta dhe afatgjata;
- 10.1.9 Punë e vazhdueshme edukative me tifozët që janë pjesë përbërëse e Sportit, me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike sportive;
- 10.1.10 Përkrahja e organizimit të klubeve dhe organizimeve për persona me aftësi të kufizuara.

Neni 11

Projektet nga veprimtaria e bujqësisë

11.1 Projektet nga lëmi i bujqësisë subvencionohen për aktivitetet vijuese:

- 11.1.1 Subvencionimi i projekteve nga lëmi i pemëtarisë, lavërtarisë, blegtorisë, shpeztarisë, perimtarisë etj., pastaj përmes panairove dhe përkrahjes me farëra dhe plehra;
- 11.1.2 Subvencionimi i shoqatave të cilat kanë për qëllim zhvillimin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Mitrovicës;
- 11.1.3 Subvencionimi i projekteve për ngritjen e baseneve për rritjen e peshkut.
- 11.2 Në rastet kur subvencionohet një grup fermerësh përmes ndonjë ndërmarrje prodhuese bujqësore, atëherë ndërmarrja e cila do t'i furnizojë fermerët me material ose mekanizëm bujqësor duhet të përzgjidhet përmes procedurave të prokurimit respektivisht të lidhë kontratë.
- 11.3 Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural paraprakisht duhet t'i drejtohet Kryetarit të Komunës me propozim-vendim për lejimin e shpenzimit të subvencioneve për gjashtëmujorin e parë e më pastaj edhe për të dytin, që do të thotë se realizimi i projekteve të cekura më lartë mund të bëhet vetëm me vendim të Kryetarit.
- 11.4 Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë përfshinë vendimin e Kryetarit për projektin në fjalë, kontrata, lista e përfituesve, raporti i komisionit dhe fatura.

- 11.5 Me rastin e shqyrtimit të kërkesave nga lëmi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përparësi do të kenë projektet të cilat realizohen me bashkëfinancim të mjeteve, ndërsa procesi i përzgjedhjes së përfituesve do të bëhet nga komisioni përkatës i kësaj drejtorie.

Neni 12

Subvencione në lëmin e shëndetësisë

- 12.1 Komuna ndan subvencione për ndihmë qytetarëve për përballimin e shpenzimeve të mjekimit, sipas kritereve të përcaktuara nga Drejtoria për Shëndetësi.
- 12.1.1 Drejtoria për Shëndetësi bën pranimin e kërkesave të qytetarëve të sëmurë për ndarjen e ndihmave në lëmin e shëndetësisë, e përgatitë formularin e aplikimit me të dhënat përkatëse, drejtoria formon komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të cilat duhet të jenë të argumentuara në bazë raportit të mjekut specialist, fotokopjen e letërnjoftimit, dokumentin përkatës që personi është rast social, llogarinë bankare dhe dokumente tjera që mund ta plotësojnë aplikimin.
- 12.1.2 Ndarja e subvencioneve në lëmin e shëndetësisë do të aplikohet deri në miratimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Neni 13

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndihma në lëmin e shëndetësisë, harton një raport pune i cili i dorëzohet Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi i cili i rekomandon Kryetarit të Komunës që të miraton vendimet për ndarjen e subvencioneve sipas kritereve të përcaktuar në këtë raport.

Neni 14

Subvencionet në Drejtorinë për Integritet dhe Mirëqenie Sociale

- 14.1 Drejtoria për Integritet dhe Mirëqenie Sociale i shqyrton kërkesat e qytetarëve të Komunës për ndihmë financiare të natyrës emergjente, për tejkalimin e gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale, ndërsa vendimin për ndarjen e ndihmave e miraton Kryetari i Komunës.
- 14.2 Drejtoria për Integritet dhe Mirëqenie Sociale do të përkujdeset edhe për realizimin e procesit të ndarjes së subvencioneve për ndërtimin, përkatësisht përfundimin e objekteve të banimit të qytetarëve të cilët nuk e kanë të zgjidhur problemin e strehimit, duke i mbështetur me material deri në vlerën financiare maksimale prej 2.000 €.
- 14.3 Këto mjete në formë të subvencioneve do të ndahen sipas vlerësimit të komisionit sipas dëshmive të ofruara.
- 14.4 Individit duhet të dëshmohet se është rast social, ose me të meta fizike, psikike etj., të dëshmoi pronësinë e shtëpisë, të ofroi certifikatën e gjendjes ekonomike.
- 14.5 Në bazë të rekomandimit të Komisionit të Drejtorisë për Integritet dhe Mirëqenie Sociale Kryetari i Komunës bie vendim për subvencionim të rasteve sociale.

Neni 15

Përkrahja e popullatës për raste të vdekjes

Drejtoria për Integritet dhe Mirëqenie Sociale do t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për rastet e vdekjeve në Komunën e Mitrovicës. Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë është kontrata, fatura sipas kontratës, dhe certifikata e vdekjes.

Neni 16

Subvencionimi nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

- 16.1 Subvencionimi nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, bëhet për rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera e që nuk ka mundësi të parashihet natyra dhe vlera e dëmit të shkaktuar.
- 16.2 Mbulimi i shpenzimeve bëhet në bazë të raportit të vlerësimit të komisionit profesional mbi gjendjen e konstatuar dhe rekomandimeve që ofron ky komision.
- 16.3 Shpenzimi duhet të jetë i argumentuar me dëshmi si procesverbal, letërnjoftim, llogari bankare, faturë.
- 16.4 Në rastet emergjente, të përcaktuara me neni 37 paragrafi 2 nënparagrafët 9 dhe 12 të Ligjit nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, kur reagimi duhet të jetë i menjëhershëm, ndërsa zhvillimi i procedurave të parapara me këtë rregullore, e rritë rrezikun për jetë dhe dëme materiale, dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen.
- 16.5 Mjetet financiare për mbulimi i shpenzimeve sipas pikës 4 të këtij neni lejohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 17

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim i shqyrton kërkesat për ndihma të qytetarëve të komuniteteve, sipas vlerësimit të komisionit për këto raste për ndarje të subvencioneve në harmoni me rekomandimet e shefit të kësaj zyre, Kryetari i Komunës bie vendim për subvencionim.

Neni 18

Kriteret për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të OJQ-ve për subvencione

- 18.1 Promovimi i vullnetarizmit (në arsimit, avokim, kampanjë, menaxhment, aktivitete komunitare dhe ambiente etj);
- 18.2 Integrimi i grupeve të marginalizuara;
- 18.3 Fuqizimi i organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve);
- 18.4 Edukimi joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim);
- 18.5 Trajnimi i të rinjve për vetëpunësim, dhe
- 18.6 Infrastruktura për rini, për moshën e mesme, pleq dhe pensionist.

18.7 Kërkesa duhet të argumentohen me provat si në vijim:

- 18.7.1 Projekti ku përshkruhen aktivitetet dhe agjenda e planifikuar me buxhet;
- 18.7.2 Certifikata e OJQ-së;
- 18.7.3 Fotokopja e kartelës së llogarisë bankare dhe letërnjoftimi i bartësit të kartelës;
- 18.7.4 Shënimet e personit kontaktues përgjegjës;
- 18.7.5 Raporti mbi gjendjen financiare të OJQ-ës për dy vitet paraprak.

Neni 19

Subvencionet për individë dhe familje

Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara ndanë ndihmë momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës, për raste urgjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm dhe për raste tjera të arsyeshme.

Neni 20

- 20.1 Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve nga Zyra e Kryetarit për persona dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore, shumë e cila mund të jetë deri në 500.00 €.
- 20.2 Ndhimja materiale e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje.
- 20.3 Për çdo shumë më të lartë nga ajo e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, vendos Kuvendi i Komunës së Mitrovicës.

Neni 21

- 21.1 Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale:
 - 21.1.1 Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacion mjekësor të specialistit;
 - 21.1.2 Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
 - 21.1.3 Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera ose,
 - 21.1.4 Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme elementare.

Neni 22

Kërkesë për ndihmë momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet që janë banorë të përhershëm të Komunës së Mitrovicës.

Neni 23

Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave

- 23.1 Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës në përbërje të zyrtarëve komunal është kompetent për shqyrtim të kërkesave eventuale për ndihmë momentale individit apo

familjes dhe në afat prej 15 ditësh të bëjë propozimin e mundshëm për ndihmë momentale.

23.2 Kërkesat e pakompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj më tutje.

23.3 Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të Komisionit.

Neni 24

Shuma e ndihmës momentale për personat fizikë dhe familjar propozohet nga Komisioni deri në limitin e përcaktuar në nenin 21 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje. Personi dhe familja e caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 25

Komisioni, listën e specifikuar të propozuar për ndihmë momentale ia dorëzon Kryetarit të Komunës, i cili ka mundësi ta ndryshojë para se të propozohet për miratim, duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Financa dhe Zhvillim Ekonomik e Komunës së Mitrovicës.

Neni 27

Në rastë konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të rregullave financiare dhe Udhëzimit Thesarit 02 - Shpenzimi parave publike dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 MEF-it - Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, do të aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Rrustem MUSA
Rrustem MUSA